



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Nëntor 2022

Nr: 208

VENDIM

PËR
EMËRIMIN E AUDITËVE TEKNICIENË PËR MBIKËQYRJEN E PROCESIT TË
HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 61, pikat 2 e 3, të ligjit, nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGjC”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOSIN:

1. Emërimin e zj. Elena Xhina dhe z. Renald Rista auditë teknicienë për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.
2. Masa e shpërblimit për secilin prej auditëve teknicienë është 230 000 (dyqind e tridhjetë mijë) lekë për periudhën nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar.
3. Ngarkohen auditët teknicienë të propozojnë ndihmësin/it respektivë, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 ditëve nga shpallja e tij.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

